



Mjetet e Rrjeteve Sociale Plani për mbrojtje shkollave Financoni Shkollat Tona

Distrikti Shkollor i Filadelfias krijoi këtë udhëzues mjetesh për të ndihmuar në sensibilizimin ndaj ndikimit të ashpër financiar që do të ketë pandemia COVID-19 në buxhetin e Distriktit Shkollor të Filadelfias. Brenda këtij udhëzuesi do të gjeni informacione dhe mesazhe të sugjeruara nga fushata jonë Financoni Shkollat Tona, e cila ka për qëllim t'ju japin udhëzime dhe njohuri të përgjithëshme për të komunikuar me zyrtarët tanë të zgjedhur dhe vendim-marrësit e jashtëm.

Këto mjete përmbajnë mesazhe dhe imazhe që ndihmojnë në:

- **Përcjelljen e këmbënguljes dhe ndërgjegjësimit, guvernatorit Wolf, përfaqësuesve të shtetit tuaj dhe senatorit për të mos shkurtuar fondet për arsimin.**
- Përforcimin e zërit tuaj. Si qytetar i Pensilvanisë, zëri yt ka rëndësi të dëgjohet.
- Angazhimin e ligjbërësve në diskutime çështjesh që komunitarë si ju përballni në komunitetet tuaja.
- Sigurimin e informacioneve bashkëkohore dhe të sakta nga një burim i besueshëm.
- Shpërndarjen e burimeve.

Të gjitha materialet grafike dhe mesazhet e sugjeruara janë të gatshme për t'u përdorur në profilet e rrjeteve sociale dhe faqet e internetit.

Për më shumë imazhe dhe përmbajtje #FundOurSchools mund të vizitoni XXX tonë. Ju lutem përdorni hashtag-un #FundOurSchools kur postoni çfarëdo përmbajtje në lidhje me Financoni Shkollat Tona.

Kopje Teksti

Hashtag:

#FundOurSchools

Taktika:

1. Mbështetuni mbi imazhe të thjeshta që krijojnë një sens komuniteti
2. Përdorni rrjetet sociale si një hapsirë ndërtimi, bashkëpunimi dhe këmbënguljeje
3. TAG-oni përfaqësuesit e zgjedhur në postimet tuaja. Vizitoni faqen: <https://live.cicerodata.com/> për të shfaqur emrat dhe informacionet e kontaktit të përfaqësuesve tuaj.

GJUHA E RRJETEVE SOCIALE			
	INSTAGRAM	FACEBOOK	TWITTER
Shembuj Postimesh në rrjetet sociale (Të përgjithshme)	✓	Nuk mund të lejojmë Harisburgun të presë financimet për arsimin ose të përdorë ndihmat federale për të përmbushur detyrimet shtetërore. Vizitoni faqen philasd.org/fundourschools për të mësuar se si mund TË NDËRMARRËSH NJË VEPRIM QË SOT! #FundOurSchools	
	✓	Mos prisni financimet për arsimin. Distrikti Shkollor i Filadelfias po përballlet me një defiçit të madh që do të rritet deri në vlerën e 1 miliard dollarë në pesë vitet e ardhshëm. #FundOurSchools TANI [TAG ZYRTARËT E ZGJEDHUR]	
	✓	Mos ekuilibroni buxhetin e shtetit në kurriz të fëmijëve. Financoni arsimin me të njëjtat nivele të vitit 2019-2020. #FundOurSchools [TAG ZYRTARËT E ZGJEDHUR]	
	✓	Kalojani ndihmat federale strukturave shkollore për të parandaluar prerje buxhetore. Akti federal CARES, paketa stimuluese që Kongresi miratoi në Prill, përmban mbi 115 milion dollarë për studentët dhe shkollat e Filadelfias. #FundOurSchools	
	✓	Rënia ekonomike rezultat i pandemisë së COVID-19 ka goditur rëndë të ardhurat prej taksave lokale të Distriktit Shkollor të Filadelfias dhe ka potencial të fshijë gjithë progresin e bërë nga SDP në shtatë vitet para-ardhës. #FundOurSchools	
	✓	DYK:Buxheti i balancuar propozuar nga Distrikti përmban tani një zbrzëti prej 38 milion dollarësh që do të rritet në 1 miliard dollarë deri në fund të vitit shkollor 2024-2025. #FundOurSchools	

KORNIZA FACEBOOK: Trego mbështetjen tënde si një kampion i #FundOurSchools në Facebook. Korniza mund të gjendet duke kërkuar #fundourschools kur zgjedh një kornizë të re profili.